



Raporti i Progresit i Muajit Qershor 2017

Programi SCPA ka zhvilluar përgjatë muajit Qershor 2017 këto aktivitete kryesore si vijon: Takimi i parë i Grupit të Përbashkët të Punës në nivel lokal (DVP) Elbasan; Një takim i Grupit të Punës për studimin e detajuar mbi funksionimin dhe organizimin e DVP Elbasan; Hartimi i disa dokumenteve në kuadër të Raportit të Ngjizjes së programit: Planit të Ndërtimit të Kapaciteteve, Planit të Skemës së Granteve, Planit të Barazisë Gjinore, Strategjisë së Daljes, Planit të Veprimit të Detajuar për vitin e parë etj.; Takime të vazhdueshme me autoritetet e SHP të ASP dhe agjencitë ndërkombëtare në mbështetje të PSH-së.

Më poshtë një përshkrim i shkurtër i aktiviteteve kryesore:

- Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes Teknike me DVP pilot të Elbasanit, Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP) organizoi takimin e parë të GPP-DVP pilot më 14 qershor 2017. Në këtë takim pati një pjesëmarrje të plotë nga 5 Komisarariatet dhe sektorët kryesorë të DVP Elbasan. Takimi u mbyll me 3 vendime si më poshtë:
 - Komisarriati i Librazhdit u përzgjedh për pilotimin e modelit të miratuar, por ndërkohë një sërë aktiviteteve do kryhen paralelisht edhe në 4 komisarariatet e tjera .
 - Zëvendës Drejtori i DVP Elbasan emërohet si koordinator / ndërlidhës midis PMT dhe DVP Elbasan.
 - Detajimi i planeve të GPP dhe zbatimi i aktiviteteve duhet të fillojë në Shtator 2017..
- Më 22 qershor, EMP organizoi takimin e parë të Grupit të Punës për kryerjen e një studimi të detajuar mbi funksionimin dhe organizimin e DVP Elbasan. GP është ngritur me urdhrin zyrtar të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH-së me qëllim skanimin e situatës aktuale dhe dhënies së rekomandimeve për përmirësimin e situatës. Takimi u bashkë-kryesua nga Drejtori për Sigurinë Publike në DPPSH dhe Drejtuesi i EMP-së. Takimi u mbyll me vendimet e mëposhtme:
 - Një listë e pyetjeve / problemeve, nga secili anëtar i Grupit të Punës, do të hartohet dhe do të dërgohet tek koordinatorja e GP, me e-mail deri më 3 korrik 2017
 - Takimi i dytë i Grupit të Punës do të zhvillohet në Elbasan, në ditën 10-15 korrik 2017.
- Gjatë muajit qershor aktivitetet kryesore të PMT u përqendruan në hartimin e dokumenteve të rëndësishme të Raportit të Ngjizjes, siç janë Plani i Ngritjes së Kapaciteteve, Plani i Skemës së Granteve, Plani i Barazisë Gjinore, Strategjia e Daljes, Plani i Veprimit i Detajuar për vitin e parë, Matricat e rezultateve dhe Planin e Monitorimit me detyra të ndara për secilin aktor. Puna, e kryer deri më tani, është në përputhje me planin kohor.
- Ndërkohë, EMP ka organizuar një sërë takimesh me autoritetet e DPPSH-së për të diskutuar tema të ndryshme që lidhen me planin e punës të raportit të ngjizjes . Si përfundim, EMP vazhdon të ketë mbështetjen e plotë të përfituesit në përmbushjen e aktiviteteve të përbashkëta.
- Dy ekspertë të SCPA realizuan një takim me përfaqësuesin e OSBE-së për çështjet e policisë. Qëllimi i takimit ishte koordinimi i aktiviteteve, për të shmangur mbivendosjen dhe për të bashkëpunuar në kryerjen e Anketimeve për Sistemin e Matjes së Sigurisë Lokale në Elbasan, si dhe aktivitete të përbashkëta në lidhje me ngritjen e Këshillave të Sigurisë vendore në të gjithë Shqipërinë. Takimet pasuese do të mbahen javën e ardhshme dhe me 17 Korrik do të diskutohet më qartë për detajet e një bashkëpunimi të tillë dhe për t'u përgatitur për një marrëveshje bashkëpunimi midis SCPA dhe OSBE.